VENDIM
Nr.667, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BËRXULL TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Bërxull të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bërxull të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.1495, datë 12.11.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërxull të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bërxull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuan Bërxull Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
5-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
9-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
13	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
15	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
16-21	Varreza publike	Në pronësi
22-24,26-84	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
85-90	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
91-92	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi